



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 314 Prot.

Tiranë, më 01.03.2018

VENDIM Nr. 34, datë 21.02.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2, datë 21.02.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit Hidroenergjitik të Devollit*"; "*Projekti i Rrugëve përgjatë Bregut Jugor të Rezervuarit të Moglicës-Seksioni 2B (Gjinikas-Osojë)*" -subjekti "Devoll Hydropower" sh.a., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit Hidroenergjitik të Devollit*"; "*Projekti i Rrugëve përgjatë Bregut Jugor të Rezervuarit të Moglicës-Seksioni 2B (Gjinikas-Osojë)*"-subjekti "Devoll Hydropower" sh.a., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.
2. Subjekti "Devoll Hydropower" sh.a. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit në kuadër të projektit Hidroenergjitik të Devollit"; "*Projekti i Rrugëve përgjatë Bregut Jugor të Rezervuarit të Moglicës-Seksioni 2B (Gjinikas-Osojë)*", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al